



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 33/3 prot.

Tiranë, më 2.2.2023

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 7.2.2023, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Kastriot Gramshi

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 9.5.2022, është njoftuar vendimi nr. 519, datë 25.3.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar Komisioni), me vendimin nr. 519, datë 25.3.2022, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c¹” të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 65, pika 2² e ligjit nr. 84/2016, një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar ONM), kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, aktin nr.187/1 prot., datë 16.5.2022: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”.

¹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: “*u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim*”.

² Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2 të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, bazuar në Rekomandimin e paraqitur nga VN të ONM-së, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me: (i) saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë “Shtëpi me sip.180 m², ndodhur në New York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës”; (ii) saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e depozitave/kursimeve në llogari bankare në SHBA; si dhe (iii) përfshirjen në analizën financiare për pasuritë më sipër të periudhës kohore përpara vitit 2005, sikundër do të trajtohet në vijim:

1. Për pasurinë shtëpi me sip. 180 m², ndodhur në * ***, Bronx, New York ***(SHBA), nga hetimi administrative ka rezultuar se:**

1.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi me sip. 180 m², *** ***, Bronx, New York ***(SHBA), blerë në datën **.5.2012. Çmimi i blerjes: 290.000 USD. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kursime të akumuluar para emërimit si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, datë **.7.2014, si dhe kredi e marrë nga *** ***, Bank.*

1.1.1 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kredi ndaj *** ***, Bank USA, deri më datë **.12.2016, shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer është 184.646 USD. Shlyerja fillon më **.5.2012 dhe përfundon më **.5.2032. Interes fiks 4,25%, kësti mujor (përfshirë principal + interesa) 1.879,3 USD.*

1.2 Në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (DPFD), dorëzuar më **.8.2014, subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi, sip.180 m² (SHBA), *** ***, Bronx, New York ***, blerë në datën **.5.2012. Çmimi i blerjes: 290.000 USD. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Pagim i këstit fillestar prej 29.000 USD dhe kredi nga *** ***, Bank, në vlerën 261.000 USD.*

1.2.1 Në të njëjtën deklaratë në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kredi për blerje shtëpi banimi, me sip. 160 m² (SHBA), në *** ***, Bank, më **.5.2012, në shumën 261.000 USD, me afat 20 vjet. Shlyerja fillon më **.5.2012 dhe përfundon më **.5.2032, me interes fiks 4,25% në vit dhe me këst mujor 1.346,84, plus taksa dhe sigurim pasurie mbi pronën e paluajtshme (4.000 USD në vit). Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer deri në datën e fillimit të punës, subjekti ka deklaruar shumën 217.500 USD.*

1.3 Lidhur me burimin e deklaruar: *Kredi e marrë nga *** ***, Bank, gjatë hetimit administrativ, sikundër trajtuar gjerësisht në ankim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:*

(i) Në pyetësin standard, subjekti deklaron: *[...] Në vitin 2012, financuar në shumën prej 261.000 USD nga *** ***, Bank për blerjen e shtëpi banimi dyfamiljeshë, në adresën: *** ***, Bronx NY, ***, me bashkëpronar Kastriot Gramshi dhe ***.*** [...], ndërsa në përgjigje të*

pyetjes 9, të po këtij pyetëtori deklaroi: [...] Blerje shtëpi banimi e përbërë nga dy apartamente/dyfamiljeshe, në bashkëpronësi me vëllain, ***.***... Çmimi i blerjes 290.000 USD. Kësti i parë/down payment 29.000 USD. Ndërsa diferenca prej 261.000 USD, kredituar nga *** ** Bank [...].

(ii) Në Pyetëtorin nr. 2, subjekti deklaroi: [...] Diferenca e çmimit (pas pagesës së kështit të parë/down payment), është kredituar nga *** ** Bank [...].

(iii) Në Pyetëtorin nr. 3, subjekti deklaroi: [...] Pagesa e kështit të parë (down payment on contract) e kërkuar nga Banka është 10% e vlerës së shitjes së pasurisë, në vlerën 29.000 USD. Kjo shumë e paguar nga të dy vëllezërit, por transaksioni është kryer nga unë për llogari të zyrës avokatore... Shuma e kredituar (Morgage) nga *** ** Bank është 217.500 USD³ [...].

1.4 Komisioni, në “Rezultatet e hetimit administrativ”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve: “(i) Subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në DPFD-në e vitit 2014, si dhe në pyetëtorin standard në lidhje me shumën e kredisë bankare të marrë për blerjen e banesës në SHBA, duke e deklaruar atë në shumën 261.000 USD, pra në një vlerë më të madhe se vlera e aprovuar dhe e disbursuar e kësaj kredie prej 217.500 USD; (ii) subjekti nuk ka deklaruar pagesën e shumës prej 46.638,43 USD, paguar prej tij dhe vëllait të tij, për blerjen e banesës në New York, SHBA, duke u mjaftuar vetëm me deklarimin e pagesës së paradhënies në shumën 29.000 USD; (iii) subjekti dhe familja e tij, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar në total shumën prej 75.638,43 USD, e cila ka shërbyer si down payment/pagesë e kryer brenda datës **.5.2012”.

1.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur, ka deklaruar se në DPFD-në e vitit 2014, si dhe në pyetëtorin standard, deklarimet e shumës së kredisë bankare në vlerën 261.000 USD, janë bërë me qëllimin për të krijuar konsistencë dhe jo konfuzion, duke iu përmbajtur kushteve thelbësore të kontratës së shitjes së pasurisë, sipas të cilës vlera e blerjes prej 290.000 USD, përbëhet nga down payment/kapar 29.000 USD dhe 261.000 kredi bankare. Ndërsa, në seksionin “Detyrime”, ai ka deklaruar vlerën e kredisë 217.000 USD. Kjo ka qenë mënyra se si e ka kuptuar formularin e deklarimit në vitin 2014, deklarim i cili ka vijuar edhe në pyetëtorin standard, duke ndjekur të njëjtën logjikë. Në vijim të argumenteve të tij, subjekti vijon të parashtojë se, pasi është pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, ai ka sqaruar të gjithë situatën, duke paraqitur edhe çeqet e paguara për përfundimin e transaksionit për blerjen e shtëpisë.

1.6 Komisioni, në analizë të prapësimeve të subjektit, në përgjigje të barrës së provës, në përfundim, ka arsyetuar se⁴: [...] i çmoi bindëse pretendimet e subjektit, duke vlerësuar se: (i) deklarimi i kredisë së marrë nga *** ** Bank si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt

³ Subjekti ka vazhduar me deklarimet: Me qëllim finalizimin e kontratës së shitblerjes është kërkuar që diferenca e çmimit [(290.000 USD – 29.000 USD - 217.500 USD) me shumën e kredituar nga *** ** Bank], duhej të mbulohej nga pala blerëse. Meqenëse nga ana jonë (pala blerëse) është rënë dakord të vijohej me procedurën e blerjes së kësaj pasurie, dhe shuma e paguar nga kursimet e të dyve, por transaksioni është kryer nga ana e vëllait, *** **, për llogari të *** ** (Banka kredituese e shitësit të pronës) shuma prej 46.638,43 USD (shihni Cashier’s Check NON NEGOTIABLE, dt. **.21.2012).

⁴ Referohuni arsyetimit të Komisionit në faqen 25-26 të Vendimit.

verifikimi, jo në vlerën 217.5000 USD, por në vlerën 261.000 USD, në DPFĐ-në e vitit 2014 (dhe pyetësorin standard), është bërë duke iu referuar përcaktimit të kontratës së shitjes së datës **.2.2012, ndërkohë që në rubrikën “detyrime financiare” të DPV-së për vitin 2014, subjekti ka deklaruar saktësisht kredinë në vlerën 217.500 USD; (ii) mosdeklarimi në DPFĐ-në e vitit 2014, por edhe në vijim në pyetësorin standard, i shumës prej 46.638 USD, paguar nga vëllai i subjektit, në datën **.5.2012, nuk është bërë me qëllim fshehjen e kësaj pagese, por për të qenë në të njëjtën linjë me kontratën e shitjes më datë **.2.2012, sidomos në kushtet kur është vërtetuar se pagesa e kësaj shume është kryer me çek në rrugë bankare, një fakt lehtësisht dhe tërësisht i evidentuar. Për më tepër, në përfundim të procesit, u vërtetua se subjekti dhe vëllai i tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për të kryer këtë pagesë brenda datës **.5.2012, çështje e trajtuar në vijim, në paragrafët 48 dhe 49 të këtij vendimi; (iii) Për rrjedhojë, pasaktësitë e evidentuara, të cilat nuk kanë sjellë asnjë pasojë, nuk mund të përbëjnë shkak për penalizim të subjektit. Në këtë vlerësim, Komisioni i referohet edhe qëndrimit tashmë të konsoliduar nga Kolegji dhe praktikës së Komisionit, të cilat konsiderojnë se pasaktësitë në deklaratimet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore, në rastet kur nuk kanë sjellë pasojë”.

1.7 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara në dosje të Komisionit, bazuar në Rekomandimin për paraqitje ankimi, datë 16.5.2022, i drejtohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, për çështjen e pasaktësisë në deklaratim të subjektit z. Gramshi, duke pasur në vëmendje rrethanat e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së⁵, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 24.5.2022 (prg. 16.7.1 deri në 16.7.4).

1.8 Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e pasqyruara në Deklaratën e parë para fillimit të detyrës, D-Vetting, si dhe përgjigjet gjatë hetimit administrativ në Komision deri në përgjigjet e subjektit në Pyetësorin nr. 3, janë të pasakta dhe të paplota për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë “Shtëpi me sip.180 m², në New York, SHBA”, deklaratim i pasaktë për shumën e kredisë disbursuar nga *** Bank, si dhe deklaratim i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për pagesën e kështit të dytë, në shumën 46.680 USD.

1.9 Në lidhje me burimin e krijimit të pagesave të kështit të parë, në vlerën 28.000 USD dhe kështit të dytë, në vlerën 46.638 USD, për këtë pasuri:

1.9.1 Komisionit, nga analiza financiare për periudhën 2005 - **.5.2012, mbi mundësinë e subjektit dhe personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur me të, për të paguar shumën 75.638 USD, për blerjen e pasurisë në New York, SHBA, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera familjare, i ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar shumën 75.638 USD, për blerjen e pasurisë: “Shtëpi me sip. 180 m², në New York, SHBA”, për një balancë negative prej – 131.085 USD, për të cilën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës.

1.9.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka kërkuar rishikim të analizës financiare lidhur me⁶: (i) reduktimin e shpenzimeve të jetesës për të gjithë familjen; (ii)

⁵ Referohuni pikës 2, germa “a”, faqe 2-6 të Rekomandimit të ONM-së.

⁶ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në f. 22 e në vijim të prapësimeve.

përfshirjen e të ardhurave të rimbursuara nga taksat, nga shteti amerikan, për familjen e subjektit dhe vëllait të tij, si dhe rishikimin e të ardhurave të babait të tij, z. ***.***⁷; (iii) rishikimin e balancave të likuiditeteve në llogaritë bankare, bazuar në mundësinë e kursimit të përlllogaritur nga Komisioni, në mungesë të akteve mbi gjendjet e llogarive bankare për periudhën deri në **.5.2012; (iv) mospërfshirjen e investimit në pasurinë “automjet”, në shumën 13.000 USD, e lidhur me pamundësinë për të vënë në dispozicion të hetimit balancat e llogarive bankare që nga viti 2004 e në vijim; (v) rishikimin e shumës të marrë me vete nga subjekti dhe familjarët e tij, kur kanë shkuar në SHBA, në total në vlerën 20.000 USD; (vi) për vitet 2003-2004, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar *pamundësi objektive* për të siguruar dokumentacion kaq të hershëm lidhur me të ardhurat.

1.9.3 Komisioni, pasi ka vlerësuar pretendimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti, në përfundim ka vlerësuar⁸ të bazuara pjesërisht pretendimet e subjektit, ato mbi përfshirjen në analizën financiare të shumave të rimbursuara nga taksat, nga shteti amerikan, për subjektin dhe vëllain e tij; rishikimin e të ardhurave nga puna e të atit të subjektit në SHBA dhe ato si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.; rishikimin e balancave të likuiditeteve në llogaritë bankare në datën e blerjes së pasurisë, si dhe ka rishikuar pjesërisht shpenzimet e jetesës për periudhën e analizuar 2005 - **.5.2012.

1.9.4 Komisioni, gjithashtu, ka vlerësuar se analiza duhet të fillojë nga viti 2005, duke arsyetuar se: (i) për periudhën gusht 2003 - dhjetor 2004, shuma prej 20.000 USD, deklaruar si e disponuar në *cash* në momentin e largimit në SHBA, ka qenë e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës për këtë periudhë⁹; (ii) subjekti nuk ka krijuar pasuri në vitet 2003-2004 dhe as likuiditete të mbartura në Deklaratën “Vetting”; (iii) llogaria bankare e subjektit është çelur në gusht 2004, për arsye praktike dhe jo për të krijuar pasuri/likuiditete; (iv) subjekti nuk ka pretenduar që të ardhurat e periudhës 2003-2004 të kenë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie; (v) subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI dokumente shkresore për të ardhurat që nga viti 2005; (vi) këto dokumente janë printuar nga sistemi i taksave në vitin 2014, vit në të cilin subjekti ka pasur mundësi që teknikisht të printonte dhe të ardhurat për vitin 2004. Fakti që nuk e ka bërë, përforcon bindjen se subjekti ka dashur të deklarojë si burim krijimi të pasurive, të ardhurat nga viti 2005 e në vijim¹⁰.

1.9.5 Komisioni, ndër të tjera, ka vlerësuar edhe se: [...] *I pyetur nga Komisioni në lidhje me të ardhurat e periudhës gusht 2003 - dhjetor 2004, si në parashtrime, ashtu edhe në përgjigje të Pyetësorit nr. 6, subjekti, me të drejtë, ka deklaruar se sot është në pamundësi objektive që të dokumentojë këto të ardhura*”¹¹, duke vlerësuar në përfundim se: *u vërtetua se subjekti, z. Gramshi, ka pasur të ardhura të ligjshme për të paguar shumën 75.638 USD, deri në datën **.5.2012, për blerjen e pasurisë “Shtëpi me sip. 180 m², në New York, SHBA”.*

⁷ Lidhur me këto të ardhura, subjekti ka pretenduar se për vitet për të cilat mungojnë aktet, të llogariten me metodën e analogjisë, dhe bazuar në aktet dhe arsyetimin mbi ligjet në fuqi të shtetit amerikan për përfitimin e masës së pensionit.

⁸ Referohuni prg. 49, të Vendimit të Komisionit.

⁹ Komisioni, fillimisht, në rezultatet e hetimit ka konsideruar që subjekti dhe familjarët kishin marrë me vete shumën 60.000 USD, por e ka rishikuar këtë shumë në bazë të prapësimeve të subjektit.

¹⁰ Referohuni arsyetimit të Komisionit në prg. 49.1 të Vendimit.

¹¹ Referohuni prg. 49.1, pika v, të Vendimit të Komisionit.

1.9.6 *Komisioneri Publik*, në analizë të akteve të administruara në dosje të Komisionit, bazuar në rrethanat e parashtruara në *Rekomandimin*¹² për paraqitje ankimi datë 16.5.2022, i drejtohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, për çështje lidhur me: (i) pamundësinë objektive të pretenduar për paraqitje dokumentacioni nga subjekti, z. Gramshi, për periudhën 2003-2004; dhe (ii) pamjaftueshmërinë financiare për pagesat e këstit të parë dhe të dytë për pasurinë: “*Shtëpi banimi me sip. 180 m², në New York, SHBA*”, për sa vijon:

1.9.7 Për pamundësinë objektive të pretenduar

1.9.7.1 [...] Lidhur me pretendimin mbi pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacion për vitet 2003 dhe 2004, në momentin e deklarimit para fillimit të detyrës, në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit nuk ishte në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion që provonte të ardhurat e ligjshme në periudhën 2003-2004. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit u bë rezident i ligjshëm në SHBA në muajin korrik 2004 [...].

1.9.7.2 [...] Duhet theksuar se është në diskutim nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme për periudhën gusht 2003 – korrik 2004, për sa kohë që nuk kishte leje punë nga autoritetet e SHBA-së. Gjithashtu, edhe i ati dhe i vëllai, nuk mund të krijojnë të ardhura të ligjshme për të njëjtën periudhë, për të njëjtat arsye [...].

1.9.7.3 [...] Pasur parasysh se subjekti nuk ishte i ligjshëm për punë deri në muajin korrik 2004, dhe se ai nuk ka paraqitur dokumentacion për periudhën 2003 - 2004, ky është një tregues që nuk ka pasur të ardhura të ligjshme deri në vitin 2005 [...].

1.9.8 Për pamjaftueshmërinë financiare

1.9.8.1 [...] ONM është e qëndrimit se vlerësimi i pasurisë dhe analiza financiare përkatëse duhet, gjithashtu, të përfshijë edhe vitet përpara 2005, veçanërisht vitet 2003-2004. Në këto kushte, subjekti dhe familja e tij do të rezultojnë në pamundësi financiare për të paguar këstin e dytë dhe analiza financiare do të rezultonte me një balancë negative prej rreth – 16.088 USD [...].

1.9.8.2 [...] Marrë në konsideratë se: (i) shuma e transferuar nga familja Gramshi në SHBA ka qenë 20.000 USD; (ii) shpenzimet minimale të jetesës për vitet 2003-2004 ishin rreth 50.000 USD, shumë e cila është më e lartë se shuma 20.000 USD, e konsideruar nga Komisioni për të mbuluar shpenzimet e jetesës për këtë periudhë; (iii) subjekti i rivlerësimit, asnjëherë, nuk ka deklaruar se pasuritë e krijuara në SHBA të kishin si burim të ardhurat e periudhës 2005-2014, përkundrazi, ai ka deklaruar që pasuritë e krijuara në SHBA kishin si burim të ardhurat përpara fillimit të detyrës, në vitin 2014, çka nënkupton të gjithë periudhën midis viteve 2003-2014 dhe periudha përpara 2003 është jorelevante, pasi subjekti ka deklaruar se shuma e transferuar nga Shqipëria në SHBA ishte vetëm 20.000 USD [...].

1.9.8.3 [...] Konkluzioni i Komisionit në prg. 49.1: (i) “se asnjë pasuri nuk është krijuar në periudhën 2003-2004, është i pasaktë”. Megjithëse balanca e llogarisë bankare (që është një pasuri) në vitin 2004 është e panjohur, sipas deklarimit të subjektit, ajo është hapur në vitin 2004 [...].

1.9.9 *Komisioneri Publik* vëren se rrethanat e pasqyruara në Rekomandimin e ONM-së, përkundrejt pretendimit të subjektit për pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion

¹² Referohuni pikës 2, germa ‘c’, faqe 9; germa ‘a’, faqe 6; dhe germa ‘b’, faqe 7-8 të Rekomandimit të ONM-së.

justifikues ligjor për të ardhurat e ligjshme në periudhën 2003-2004, dëshmojnë se subjekti, z. Gramshi, në momentin e plotësimit të *Deklaratës së parë para fillimit të detyrës (dorëzuar më **8.2014)*, e kishte mundësinë që ofronte sistemi i IRS¹³ për të siguruar dokumentacion, së paku për vitin 2004, ndaj dhe pamundësia objektive, sipas kuptimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk gjendet e justifikuar.

1.9.10 *Komisioneri Publik*, sa më sipër, vlerëson se, në konsideratë të kryerjes së analizës financiare, duke nisur që nga viti 2003 (muaji shtator), marrë në konsideratë si të ardhura në dispozicion të subjektit dhe familjarëve të tij, për periudhën 2003-2004, edhe shumën prej 20.000 USD (deklaruar të marrë *cash*) dhe shpenzimet minimale të jetesës për të njëjtën periudhë¹⁴, nga rezultatet e analizës financiare do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare për periudhën shtator 2003-**5.2012, për një shumë të akumuluar në vlerën rreth - 16.000 USD, dhe subjekti i rivlerësimit do të gjendej në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasurinë: “*Shtëpi me sip.180 m², në New York, SHBA*”.

2. Për pasurinë e luajtshme, depozita në * Bank dhe *** Bank, në New York, SHBA, nga hetimi administrativ, ka rezultuar se:**

2.1 Në *D-Vett.*, subjekti ka deklaruar: depozita bankare respektivisht: (i) *Depozitë *** Bank (New York, USA) krijuar në gusht 2004 dhe gjendje më datë **12.2016, shuma 82.684,64 USD. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat;* (ii) *Depozitë *** Bank (New York, SHBA), krijuar në nëntor 2013 dhe gjendje më datë **12.2016, shuma 263,51 USD. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga pagat.*

2.2 Në *Deklaratën para fillimit të detyrës*, subjekti ka deklaruar: (i) *Depozitë *** Bank (New York, SHBA), krijuar në gusht 2004 dhe gjendje më datë **7.2014, shuma 97.614,28 USD, me pjesë takuese 100%, dhe më burim krijimi: Të ardhurat nga paga;* (ii) *Depozitë *** Bank (New York, USA), krijuar në nëntor 2013 dhe gjendje më datë **7.2014, shuma 12.736,66 USD, me pjesë takuese 50%, dhe me burim krijimi: të ardhurat nga pagat.*

2.3 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka vlerësuar se deklarimi i subjektit përputhet me gjendjen e llogarive respektive në datat **7.2014 dhe **12.2016. Për sa iu përket të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e këtyre depozitave në vlerën totale prej 110.351 USD, në datën **7.2014, Komisionit, fillimisht, nga analiza financiare për periudhën 2005-**7.2014, i ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për t'i krijuar këto depozita për një diferencë negative prej -156.153 USD, diferencë për të cilën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

2.4 Në përgjigje të barrës së provës, në prapësimet e tij, subjekti ka pretenduar se në analizën financiare të Komisionit duhet të reflektohen të njëjtat shpjegime dhe argumente të trajtuara gjerësisht në analizën financiare të kryer deri në momentin e blerjes së pasurisë “*Shtëpi me sip.*

¹³ Internal Revenue Service/Shërbimi i brendshëm i të ardhurave.

¹⁴ Shtator 2003-prill 2004 për 3 persona dhe maj 2004-dhjetor 2004 për 4 persona, si dhe shtuar shpenzimet për qira për periudhën shtator 2003-dhjetor 2004.

180 m²”, New York, SHBA”, në vitin 2012, duke kërkuar përfshirjen edhe të:“(i) shumës së taksave të rimbursuara nga shteti gjatë viteve 2013 dhe 2014, në shumën totale 16.919 USD (10.520/viti 2013+6.399/viti 2014); (ii) të ardhurat nga puna e babait deri në momentin e plotësimin të dokumentacionit për pension dhe më pas përfitimet nga pensioni i parakohshëm i pleqërisë”¹⁵.

2.5 Komisioni, pasi ka vlerësuar pretendimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti, në përfundim ka vlerësuar se ai ka pasur mundësi të krijojë depozitat objekt verifikimi me të ardhura të ligjshme të krijuara në SHBA¹⁶.

2.6 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar në rrethanat e parashtruara në Rekomandimin¹⁷ për paraqitje ankimi, datë 16.5.2022, i drejtohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, për çështjen e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, z. Gramshi dhe personave të lidhur me të e të tjerë të lidhur me të, pasi vlerësohet se, për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të kursimeve në depozitat bankare deri në datën **.7.2014, sikundër arsyetuar më sipër në trajtimin e pasurisë: “Shtëpi me sip. 180 m², në New York, SHBA”, edhe në këtë rast, analiza financiare duhet të kryhet për periudhën duke filluar që nga muaji shtator 2003. Subjekti i rivlerësimit, edhe në këtë rast, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe justifikimin me burime të ligjshme të pasurive të luajtshme (depozitave bankare) dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të identifikuar për periudhën shtator 2003 - **.7.2014¹⁸.

3. Përveç sa më sipër trajtuar, Komisioneri Publik, bazuar në aktin “Rekomandim për paraqitje ankimi”, vlerëson se pamjaftueshmëria e konstatuar ndër vite, sikundër trajtuar gjerësisht në dy çështjet e mëparshme, do të ndikonte dhe rezultatin financiar të akumuluar të vitit 2015 (vit në të cilin është shlyer pjesërisht kredia për shkollimin e bashkëshortes së subjektit), duke e kthyer atë në negativ.¹⁹

I. Kërkimi i ankimit

4. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe në një çmim të drejtë të provave të administruara;

5. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar

¹⁵ Referohuni shpjegimeve të subjektit në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, f. 36 e në vijim.

¹⁶ Referohuni arsyetimit në paragrafët nr. 70.2 - 70.3, të Vendimit të Komisionit.

¹⁷ Referohuni pikës 2, germa “b”, faqet 8-9 të Rekomandimit të ONM-së.

¹⁸ Në këtë rast, sipas analizës së kryer nga Komisioni, do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare e burimeve të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të, në vlerën rreth -25.863 USD, pamjaftueshmëri e cila llogaritet si rezultat i shumatores së mundësisë së kursimeve të subjektit të rivlerësimit për vitet 2003 - **.7.2014.

¹⁹ Referohuni f. 10 të Rekomandimit: “Për vitin 2015, balanca negative është në shumën -21.149 USD, në këtë vit, subjekti ka shlyer shumën 8.532 USD për huan e bashkëshortes. Balanca negative në fund të vitit 2015 tregon se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të paguar pjesërisht huan (në referencë të paragrafit 72.4, të Vendimit të Komisionit).

gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ligjit të zbatueshëm dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

6. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, pas vlerësimit në seancë publike të shkaqeve të ankimit, që i përkasin procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, Kolegji të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA